



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 463106-61859 dt. 30/12/2024



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 57 të Ligjit 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në bazë të vendimit të ligjshmërisë nga MAPL-së Nr.IV-020-713/3 të datës 13.12.2024, për vendimin për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë kryetarin e komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënien e pronave me negociim. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.12.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e komisionit i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandojë kryetarin e komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënien e pronave me negociim

Neni 1

Të shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 02 Nr. 020/04-57016 të datës 29.11.2014, me të cilin është krijuar komisioni i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandojë kryetarin e komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënien e pronave me negociim.

Neni 2

Pas shfuqizimit të këtij vendimi obligohet Zyra e Kuvendit që të njoftoj MAPL-në, duke u bazuar në ligjet në fuqi.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Bekim Lestrani


Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

A R S Y E T I M

Vendimi i Kuvendit të Komunës 02 Nr. 020/04-57016 të datës 29.11.2014, me të cilin është krijuar komisioni i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandojë kryetarin e komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënien e pronave, por MAPL me vendimin ligjshëmërisë Nr.IV-020-713/3 të datës 13.12.2024, ka vlerësuar se akti i Komunës së Glllogocit nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Andaj Kuvendi Komunal / Kryetari i Komunës, duhet të ndërmarrin veprime konkrete brenda 30 ditëve mbas pranimit të vendimit të ligjshëmërisë Nr.IV-020-713/3 të datës 13.12.2024 nga MAPL.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Iladrovi, Kryetar i Komunës së Gllgocit Bekim Lestrani, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllgocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Heteni, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL.	Datë: 14.01.2025 VI-020-713/7
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Almetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllgocit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullosës (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 02 Nr. 463/06-61859 për shfuqizimin e komisionit i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandoj Kryetarin e Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie e pronave me negociim.

I miratuar më datë: 30.12.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.01.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislatorit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.12.2024, ka miratuar Vendim 02 Nr. 463/06-61859 për shfuqizimin e komisionit i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandoj Kryetarin e Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie e pronave me negocim.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, është bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 57 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, si dhe në bazë të vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL nr. IV-020-713/3 të datës 13.12.2024, me qëllim të shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 02 Nr. 020/04-57016 të datës 29.11.2024 me të cilin është krijuar komisioni i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandoj Kryetarin e Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie e pronave me negocim.

Aktë është miratuar në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Glllogocit me datë 31.10.2024, është miratuar më 23 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë vlerësim.